



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERVBAL¹

Tiranë, më 17.08.2020, ora 11.00

Drejton mbledhjen -

Vitore Tusha – zv/Kryetare e Këshillit

Rendi i Ditës :

- 1. Miratimi i procesverbaleve të përmbledhura të mbledhjeve të KED-së, të datave 10.07.2020 dhe 17.07.2020.*
- 2. Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatin për vendin vakant, për vakancën e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e rishpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 21.08.2019 dhe Presidenti i Republikës në datën 27.09.2019:
- Regleta Panajoti.*
- 3. Vendimmarrja lidhur me lejimin/ndalimin e kandidimit të kandidatit të mësipërm.*

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|--------------|
| 1. Vitore Tusha | (zv/kryetar) |
| 2. Fiona Papajorgji | (anëtare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Miranda Andoni | (anëtare) |
| 5. Saida Dollani | (anëtare) |
| 6. Fatjona Memçaj | (anëtare) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

7. Ludovik Dodaj (anëtar)
8. Arjan Qafa (anëtar)

Nuk mori pjesë, si vëzhguese e përhershme :
Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.

Mori pjesë, si e ftuar, përfaqësuese nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

Katrin Treska, përfaqësuese e Presidentit të Republikës, përfaqësuar nga autorizimi nr. 446 prot, datë 29.01.2020.

Nuk morën pjesë përfaqësuesit nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016.

HAPET MBLEDHJA

Ora 11:00

Vitore Tusha - Deklaron të hapur mbledhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, e thirrur sipas rendit të ditës. Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të KED-së, si dhe e të ftuarve të tjerë sipas subjekteve të treguara në nenin 233/2 të ligjit nr.115/2016.

Vitore Tusha lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuara paraprakisht.

- 1. Miratimi i procesverbaleve të përmbledhura të mbledhjeve të KED-së, të datave 10.07.2020 dhe 17.07.2020.*
- 2. Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatin për vendin vakant, për vakancën e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e rishpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 21.08.2019 dhe Presidenti i Republikës në datën 27.09.2019 për zonjën Regleta Panajoti.*
- 3. Vendimmarrja lidhur me lejimin/ndalimin e kandidimit të kandidaturës së mësipërme.*

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës e paraqitur për këtë mbledhje.

Anëtarët e Këshillit e miratojnë rendin e ditës.

Vitore Tusha – Si pikë e parë e rendit të ditës u miratuan procesverbalet e përmbledhura të mbledhjeve të KED-së, të datave 10.07.2020 dhe 17.07.2020 që përkonin me mbledhjet nr.6 dhe nr.7. Të dyja procesverbalet u janë komunikuar anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje sipas procedurës.

Anëtarët e Këshillit miratuan procesverbalet e përmbledhura të datave 10.07.2020 dhe 17.07.2020.

Vitore Tusha- Vijon me pikën e dytë të rendit të ditës për shqyrtimin e gjetjeve për kandidaturën e zonjës Regleta Panajoti. Relacionet e përgatitura nga relatorët, zonja Marku dhe zonja Dollani, u janë shpërndarë të gjithë anëtarëve të Këshillit dhe të ftuarve.

Saida Dollani – Në cilësinë e relatores lexon relacionin për gjetjet në procedurën e verifikimit të kandidaturës së zonjës Regleta Panajoti për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019. Relacioni, data, ora dhe rendi i ditës për këtë mbledhje u janë njoftuar zonjës Regleta Panajoti dhe sugjeroi që të përqendrohemi te gjetjet.

Sipas procedurës pyeten anëtarët nëse kanë pyetje ose sqarime.

Fiona Papajorgji - Duke qenë se është zhvilluar e gjithë proceduara nga ana e KED-së dhe në vijim edhe të asaj çfarë është thënë edhe në mbledhjen e kaluar, do të ishte mirë që në vendim të pasqyroheshin të gjitha veprimet e kryera, si shkresat e përcjella institucioneve ashtu edhe përgjigjet e administruara në këtë procedurë, shtuar këtu edhe vendimin e KPA-së, kjo në funksion të vlerësimit të të gjitha gjetjeve në këtë procedurë.

Saida Dollani - Autoritetin për verifikimin e të tre komponentëve që kërkohen për kandidatin, ligji ia njeh KPK-së dhe KPA-së. Ndërkohë, kjo kandidaturë është verifikuar me autoritetin që ligji i jep KED-së. Kështu që ne jemi të detyruar t'i zbatojmë vendimet e KPA-së. Pra, ne nuk mund ta kryejmë këtë verifikim, duke qenë se me këtë proces merret KPK-ja dhe KPA-ja. Në rastin konkret ndalimi është vendosur nga KPA-ja.

Po ashtu thekson se kryetari i KED-së i është drejtuar KPA-së me një shkresë për të proceduar në mënyrë të përshpejtuar për këtë kandidaturë, gjë që është marrë parasysh nga KPA-ja.

Fiona Papajorgji- Për transparencë dhe të publikut veprimtaritë që kemi bërë edhe për këtë candidate, të pasqyrohen siç janë kryer.

Vitore Tusha – I jep fjalën përfaqësueses së Presidentit.

Katrin Treska- Nuk kishte gjë për të shtuar.

Vitore Tusha – I jep fjalën relatores, zonjës Arta Marku.

Arta Marku- Faleminderit!

Relatimi im është për të njëjtën kandidate, por për një vakancë tjetër, atë të Presidentit të Republikës shpallur në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019. Gjetjet janë të njëjta me ato që u paraqiten nga zonja Dollani, por me një ndryshim. Në këtë vakancë zonja Regleta Panajoti ka qenë lejuar për të kandiduar me vendimin nr. 75, datë 24.07.2019 të KED-së. Më pas parashtron relacionin për kandidaten Regleta Panajoti.

Vitore Tusha – Sipas procedurës pyet anëtarët nëse kanë pyetje ose sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje.

Vitore Tusha - Përfaqësuesja e Presidentit?

Katrin Treska – Nuk ka pyetje ose sqarime.

Vitore Tusha - Të dyja relacionet e prezantuara si nga zonja Saida Dollani ashtu edhe nga zonja Arta Marku u shqyrtuan. Me dakordësinë e anëtarëve të Këshillit deklaroi mbylljen e mbledhjes dhe se Këshilli do të vijojë me vendimmarrjet përkatëse.

Mbledhja mbyllet në orën 11:18

**Tiranë, më datë
17.08.2020**

Vitore TUSHA

**SEKRETARE
Zv/KRYETARE
Vilma DOKUSHI**